



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorëzuar Planned / Delivered	08.02.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	1640/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.19/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.19/2023 të datës 05.01.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ të cilën më autorizim e përfaqëson kundër Vendimit me Nr.ref.643/2022 të datës 06.12.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike 'kërkesë nga marrëdhënia e punës', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.19/2023 të datës 05.01.2023, të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 05.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 57/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.643/2022 të datës 06.12.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli me datë 20.01.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 57/2023 të datës 05.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Ref.643/2022 të datës 06.12.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.Ref:1040/2020 të datës 18.12.2020; Vendimin me Nr.Ref:762/2016 të datës 15.12.2016 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.Ref: 020/13 të datës 20.01.2013 për emërim dhe caktim të gradës diplomatike të Ministrit të



Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.Ref:176/2014 të datës 21.03.2014 për lëvizje paralele dhe transferim të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.591/2018 të datës 13.07.2018 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.207101/2020 të datës 27.07.2020 të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.310/2020 të datës 10.07.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.120/2020 të datës 01.09.2020 për sistemim të përhershëm të lëshuar nga Z.v Sekretuari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.259/2020 të datës 30.06.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Autorizimin e datës 27.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.01.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 20.01.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.19/2023 të datës 05.01.2023 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 ka shpall Konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi. Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton së lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankuesit në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar së ankuesi bazuar në Vendimin Nr.Ref.020/13 të datës 24.01.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke i'u caktuar grada diplomatike "Sekretar i Parë", dhe njëkohësisht i njëjti caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shqipëri. Tutje, bazuar në provat e lëndës rezulton së ankuesi me Vendimin Nr.176/2014 të datës 21.03.2014 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme ishte transferuar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Hungari po me gradë diplomatike Sekretar i Parë, ndërsa sipas Vendimit me Nr.Ref. 762/2016 të datës 15.12.2016 të Ministrit të Punëve të Jashtme ankuesi ngritet nga grada diplomatike Sekretari i Parë në gradën diplomatike Këshilltar, dhe së i njëjti ka vazhduar të shërbej në shërbim të jashtëm deri në nxjerrjen e Vendimit Nr.ref: 643/2022 të datës 06.12.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me të cilin është shfuqizuar Vendimi më numër reference 020/13 të datës 24.01.2013 lidhur me emërimin e ankuesit anëtar në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës si dhe Vendimi me Nr.Ref 1040/2020 të datës 18.12.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me arsyetimin se emërimi i ankuesit në shërbim të jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkeljeve të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkeljeve të ligjit material, konkretisht Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarave politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.19/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë ; dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së